



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71041-01457-11-2017	Data e Regjistrimit	9/22/2017
Numri i Vendimit	11-2017-4750	Data e Vendimit	10/4/2017

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Petraq Çuri

ANËTAR

SEKRETARE Eriola Gashi

Objekti: Kërkesë për heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendim nr.103 datë 03.03.2017 të ***** së Shkallës së parë ***** lënë në fuqi me vendim nr.59 datë 27.03.2017 të Gjykatë së Apelit ***** .

Baza Ligjore : Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

Përmbledhja e vendimit:

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe pasiadministroi provat dhe aktet e ndodhura në dosje, dëgjoi :

Përfaqësuesit e Bashkisë së Qytetit ***** ,qëkërkuan pranimin e kërkesës;

Prokuroren, e cila, kërkoi rrëzimin e kërkesës.

Kallzuesit, që kërkuan rrëzimin e kërkesës

Vëren:***** e Qytetit ***** ,me kërkesën e saj datë 22.09.2017, ka sjellë kërkesën me objekt:

*Kërkesë për heqjen e sekuestros preventive tëvendosur me vendimin nr.103 datë 03.03.2017 të ***** së Shkallës së Parë ***** ,lënë në fuqi me vendimin nr.59 datë 27.03.2017 të ***** së Apelit ***** .*

Konstatohet se çështjaështë në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për gjykimin e saj është Gjykatae Rrethit Gjyqësor ***** .

Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se:

Më datë 02.02.2017,nëProkurorinë e Rrethit Gjyqësor ***** ,është depozituar kallzimi penal me nr.323nga Zyra Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Aleanca për Mbrojtjen e VleraveKombëtare,ndaj Bashkisë ***** , me objekt, kryerjen e veprës penale “Ndërtim ipaligjshëm”, vepër penale, kjo e parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

Gjykata e RrethitGjyqësor ***** , me vendimin nr.103 datë 03.03.2017 ka vendosur:

Tëpranojë pjesërisht kërkesën e datës 22.02.2017 të Prokurorisë së RrethitGjyqësor ***** .

“Vendosjene sekuestros preventive të pasurisë së paluajtshme,ku po kryhen punime përndërtimin e projektit “Veliera”, e ndodhur në Lagjen nr.1, pranë TorrësVeneciane



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

***** ,duke mos lejuar vazhdimin e punimeve për pjesën e projektit qështrihet në zonën "A" të qytetit të ***** it."

Kundër këtij vendimi kaushtruar të drejtën e ankimit pala kërkuese ***** e Qytetit ***** , dheGjykata e Apelit ***** , me vendimin nr.59 datë 27.03.2017,ka vendosur:

"Miratimin e vendimit nr.103 datë 03.03.2017 të***** së Rrethit Gjyqësor ***** ."

Nëkërkesën e saj pala kërkuese arsyeton se:

-Me vendimin 144 datë31.07.2017 të ASHA Tiranë,ka vendosur të miratojë "Projekt propozimin përndryshimin e projektit të rehabilitimit "Sheshi publik para hyrjes sëportit",në lidhje me ruajtjen dhe integrimin e strukturave më përfaqësuese tëzbuluara gjatë gërmimit arkeologjik,realizuar nga Instituti i Arkeologjisë dheDRKK ***** .

-Me vendimin nr.197 datë26.07.2017,KKR ka vendosur të miratojë projekt propozimin për ndryshimet eprojektit të rehabilitimit "Sheshi publik para hyrjes së portit",në lidhje meruajtjen dhe integrimin e strukturave më përfaqësuese të zbuluara gjatëgërmimit arkeologjik,realizuar nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK ***** ,mesubjekt aplikues ***** ***** .

-Pra nga organetkompetente shtetërore si KKA,ASHA,Ministria e Kulturës është përcaktuar sezbulimet të ruhen dhe integrohen në bashkëjetesë me veprën urbane,duke miratuarpër këtë qëllim ndryshimet mbi projektin civil,realizimi vijues i të cilitndiqet e monitorohet nga institucionet e specializuara shtetërore tëarkeologjisë.

-Nuk ekziston rreziku injë dëmi të rëndë mbi fragmentet arkeologjike,përkundrazi nuk kemi aspak pranitë rrezikut për dëmtimin e tyre nga zbatimi i projektit civil,poe nëpërmjetrealizimit të veprës urbane dhe gërshetimit të saj me fragmente arkeologjikegarantohet siguria dhe integriteti i plotë i tyre.

Në vendimin e saj nr.103datë 03.03.2017, kjo gjykatë arsyeton:

Referuar këtij kallezimi penal, ku citohet se ***** Durres prej disajavesh eshte duke kryer germime ne dobi te ndertimit te nje vepre urbane dhe segjate ketij procesi eshte verejtur prej qytetareve dhe jo vetem se ndeshenobjekte me vlere te kultures se antikitetit, te mesjetes te cilat pasicopetohen e thyhen hidhen pak metra me tutje ne zonen prane bregdetit dhebrenda detit, duke shkelur nenin 48/2 te ligjit "Per trashegimime kulturore", faktin qe ne baze te ligjit per "Trashegimime Kulturore" duhet njoftuarDrejtoria Rajonale Kombetare per cdo send te gjetur me vlere si dhe per faktinse punimet jane pa leje mjedisore.

Gjate kryerjes se veprimeve hetimore, u krye kqyrja e vendit te ngjarjes,konkretisht ne vendin ku kryhen punime nga ana e Bashkise Durres, ndodhur neLagjen Nr. 1, prane Torres Veneciane Durres, si dhe eshte administruarpergjigjja nga ana e Drejtorise Rajonale te Kultures Kombetare Durres. Nga kjopergjigje, informohemi se projekti "Veliera"shtrihet ne pjesen me te madhe te tij jashte zonifikimit arkeologjik dhepjeserisht ne zonen arkeologjike "A" dhe "B". Me vendimin me nr. 128 date22.11.2016 Keshilli Kombetar i Arkeologjise ka vendosur te miratoje konceptin enderhyrjes arkeologjike ne kuader te projektit "Zbatimi i sheshit publik para hyrjes se Portit Durres" sipasketyre percaktimeve:

* Per zonen nr. 1, punimete germimit te kryhen nen monitorimin e Institutit te Arkeologjise, me qellimperfitimin e nje informacioni ne lidhje me potencialin arkeologjik te kesajzone;

* Per zonen nr. 2 terealizohen nga Instituti i Arkeologjise kater sondazhe arkeologjike sipaskonceptit te paraqitur nga ky institut;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

* Per zonen nr. 3 tekryhet germimi arkeologjik nga Instituti i Arkeologjise ne te gjithethefortifikimin prej 75 m , me gjeresi 7 deri ne 10 m si dhe te realizohen dysondazhe ne pjesen perendimore te Kulles Veneciane;

* Ne zonen nr. 3 nukmiratohet kryerja e sondazhit arkeologjik ne rrugen e Deshmoreve prane Kullesveneciane;

Sipas ketij vendimiinvestitori duhet te lidhe paraprakisht akt marreveshje trepaleshe meInstitutin e Arkeologjise qe do te kryeje dhe monitoroje punimet esiperpermendura per kete projekt dhe Agjencine e Sherbimit Arkeologjik qe do terealizoj mbikqyrjen e tij. Gjithashtu me vendimin me nr. 1 date 24.01.2017 KKAka vendosur:

1. Te miratoje kerkesene Institutit te Arkeologjise per ndryshim te vendimit nr. 128 date 22.11.2016te KKA per projektin "*Sheshi publik parahyrjes se Portit te Durrresit*";
2. Pas verifikimit neterren te zones ku do te zbatohet projekti i siperpermendur , grupi ispecialisteve te Institutit te Arkeologjise dhe Bashkise Durrres, konstatuan qemuri rrethues antik eshte poshte kuotes se zbatimit te projektit dhe nuk preketnga ai;
3. Duke mos paturgermime ne thellesi bie koncepti i nderhyrjes arkeologjike miratuar me vendiminme nr. 128 date 22.11.2016, por punimet per zbatimin e projektit te monitorohenne menyre te vazhdueshme.
4. Instituti iarkeologjise ne bashkepunim me DRKK Durrres te kryejne monitorimin e punimeve tezbatisimit te projektit;
5. Investitori duhet telidhe paraprakisht akt marreveshje trepaleshe me Institutin e Arkeologjise qedo te kryeje dhe monitoroje punimet e siperpermendura per kete projekt dheAgjencine e Sherbimit Arkeologjik qe do te realizoj mbikqyrjen e tij

Nga ana e specialistevete DRKK-se Durrres ka filluar mbikqyrja e punimeve me daten 30.01.2017 referuarrelacioneve te shoqeruar dhe me tabelat fotografike ne zbatim te urdhrin tebrendshem te ketij institucioni te dates 26.01.2017.

Nga pergjigje e ardhurnga ***** Durrres na eshte vene ne dispozicion nje kopje e dokumentacionit teketij projekti, konkretisht vendimi per miratimin e lejes se ndertimit qe mbandaten 30.09.2016 me nr. 102 , ku ne kondicionet e vecanta parashikohetmosfillimi i punimeve pa vendimin e KKA Tirane. Leja e ndertimit e dates12.12.2016 me afat te fillimit te punimeve nje vit nga data e leshimit telejes. Ndersa njoftimi i fillimit te punimeve ne objekt ka daten 13.12.2016. Medate 04.02.2017 eshte vendosur pezullimi i punimeve nga firma zbatuese mearsyen e gjetjeve arkeologjike. Bashkangjitur ketij materiali eshte dhe kontratae lidhur me date 27.01.2017 midis paleve qe jane Agjencia e SherbimitArkeologjik, Instituti i Arkeologjise dhe ***** Durrres, objekt i kesajkontrate eshte rregullimi i marredhenieve juridike ndermjet paleve permonitorimin e arkeologjik te punimeve ne kuader te ketij projekti, ekonkretisht parashikohen detyrimet e seciles pale si dhe parashikohet sevelefshmeria e kesaj,kontrate fillon ne ditin kur ajo nenshkruhet.

Ne detyrimet einvestitorit parashikohet ne piken e pare se investitori nuk duhet te kryejeasnje punim pa njoftuar Agjencine e Sherbimit Arkeologjik. Te nderpresemenjehere punimet dhe te njoftoje ASHA-n per cdo gjurme arkeologjike qe delgiate zbatimit te projektit dhe se ne rast gjetjesh arkeologjike me rendesi tebeje ndryshimet e projektit sipas vendimit te KKA-se dhe ne perputhje melegjislacionin ne fuqi.

Por nga kryerja ehetimeve te metejshme lidhur me kete procedim penal, konstatohet se nga GjykataAdministrative e Shkallës së Parë Durrres me vendimin nr. 922 date 16.02.2017,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

eshtevendosur nderprerja e punimeve ne pjesen e sipërme te rruges, ne sheshin parahyrjes se Portit Durres, ne vendin ku jane gjetur fragmentet arkeologjike, (ne seksionin ku ndodhet pallati). Por nematerialin kallezues te depozituar serish ne Prokurori me date 20.02.2017pretendohet se po punohet ne shkelje te ketij vendimi gjyqesor.

Me qellim verifikimin eketij fakti, u cmua se duhej kryer rikqyrja e vendit te ngjarjes. Nga kjo rikqyrje e kryer me date 22.02.2017 rezulton se ne sheshin anash kompleksit "Fly"vihet re nje realizimi i nje muri betoni i cili eshte 40 metra lineare dhe neprofilin e rruges ekzistuese "Egnatia". Ky mur betoni fillon nga krahu lindor ,perpara lokalit "Amsterdam" qe ndodhet ne katin e pare te kompleksit "Fly" dheperfundon tek rrethimi i kantierit arkeologjik. Tek struktura arkeologjike nedisa vende vihen re disa pilota betoni te cilat ne disa vende kane prekurstrukturat arkeologjike dhe sipas inxhinierit te firmes Kreshnik Turani janebere para se te fillonin germimet rreth dates 16.12.2016. Edhe ne afersi teTorres Veneciane eshte bere nje shtrese betoni me gjeresi rreth tre metra dhegjatesi rreth 50 metra lineare.

Ne ligjin me Nr.9048,date 7.4.2003 "Per trashegimine kulturore"ndryshuar me ligjin me nr. 9882 date 28.02.2008 "per disa shtesa dhe ndryshimene ligjin "Per trashegimine kulturore, ne nenin 47 te tij parashikohet: *"Ne rastet e ndërtimeve te mëdha ne terriore ne pronësi shtetërore ose private, si rruge, autostrada, aeroporte,porte, vepra industriale, qendra te reja banimi, investitorët janë te detyruarqe, gjate procesit te projektimit dhe zbatimit te projektit, te marrinmiratimin me shkrim te Keshillit Kombetar te Restaurimeve dhe te KeshillitKombetar te Arkeologjise. Specialistet kryejnë kontrollin e zonës dhepërgatisin dokumentacionin përkatës. Kurzona përmban vlera te rëndësishme arkeologjike, etnografike ose gjurme tearkitekturës se lashte ose tradicionale, projekti duhet te ndryshoje.Propozimi për ndryshime behet nga institucionet qe kane kryer kontrollin dheshpenzimet për këto ndryshime përballohen nga investitori."*

Ne nenin 48parashikohet:

"1. Kur, pas fillimit te punimeve, zbulohen rastësishtgjurme ose objekte me vlera arkeologjiko - etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë. Drejtuesit dhe investitorët e punimeve njoftojnë, brenda tri ditëve,organet e qeverisjes vendore, Institutin e Arkeologjisë dhe Institutin eMonumenteve te Kulturës, te cilët bëjnë kontrollin përkatës, relatojnë përvlerat e gjetura dhe bëjnë propozimet përkatëse për vazhdimësinë ose jo tepunimeve.

2.Nëse gjetjet janë me vlera te rëndësishme, punimet efilluara mund te pësojnë ndryshime ose te ndërpriten përfundimisht. Vendimi nekëtë rast merret nga organi qe ka autorizuar fillimin e punimeve.

3.Ne rastin kur punimet pësojnë ndryshime, te gjitha,shpenzimetpër to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshmerestauruese ose konservuese, mbuloohen 100 për qind nga investitori."

Ne rregulloren peradministrimin e zones "A" dhe "B:" te qytetit te Durresit miratuar me vendiminme nr. 237 date 23.03.2011 te Keshillit te Ministrave ne zbatim te Ligjit "Pertrashegimine kulturore" parashikohet: "Në zonën arkeologjike "A" të qytetit të***** it lejohet:

"1. Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synimin studimin e plotë tëzonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisëdhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

2. Rikonstruksioni irrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik ujësjellës-kanalizime,ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar iArkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Për të gjitha ndërhyrjet emësipërme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

realizohet mbikëqyrje arkeologjike në mënyrë të vazhdueshme gjatëzbatimit të punimeve nga specialistët e Agjencisë së Shërbimeve Arkeologjike”.

Per sa me lartparashtruam rezulton se organi procedures eshte ne fazen e kryerjes se hetimevene kuader te ketij procedimi penal dhe se deri ne kete faze te hetimit kadyshime se ndodhemi para vepres penale te “Shperdorimit te detyres” parashikuarnga neni 248 I Kodit Penal. Keto dyshime konsistojne ne faktin se nga ana einvestitorit qe eshte ***** Durres eshte dhene leja per fillimin e punimevenga firma zbatuese pa u marre leja nga ASHA, pa u lidhur kontrata meinstitutionet ligjore qe parashikon konkretisht neni 47 I Ligjit “Pertrashegimine Kulturore”. Kjo kontrate eshte lidhur me daten 27.01.2017 ndersanjoftimi per fillimin e punimeve mban daten 13.12.2016. Per me teper nga kqyrjae kryer ne vend si dhe nga provat e tjera te marra, siac jane relacionet ekryera nga DRKK-ja Durres rezulton se jane kryer punime, germime, betonime paradates se lidhjes se kontrates, te cilat kane prekur objekte me rendesi dukesjelle pasoja po ti referohemi faktit se punimet kryhen ne nje zonearkeologjike te kualifikuar si zone “A”, pjesa siper rruges. (Shih harten sipasrregullores)

Duke qene se medisponimin e lire te siperfaqes publike ku po ndertohet projekti “Veliera”, me vazhdimin e punimeve mund te rendohen pasojat e vepres penale, pasi sicrezulton dhe nga kqyrja e kryer vazhdojne punimet nga firma zbatuese, punimeketo qe konsistojne ne betonime edhe pse referuar kontrates se dates 27.01.2017dhe percaktimeve te ligjit “Per trashegimine kulturore” dhe rregullores sesipercituar, ato duhet te pezulloheshin deri ne nje vendim tjetër te KKA-se dhene perputhje me legjislacionin ne fuqi, cmojme se duhet te vendoset sekuestropreventive ne referim te nenit 274/1 te K.Pr.Penale

Nisur nga ky arsyetimgjykata përfundimisht e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Rrehtit Gjyqësor***** , duke vendosur sekuestro preventive mbi pasurinë e paluajtshme,kundërtohet projekti “Verierë”,nga ana e e investitorit të saj ***** .

Ngapala kërkuese para kësaj gjykate u paraqitën:

-projekt me propozimetpërkatëse,shoqëruar me shkeresën nr.14239 prot datë 25.07.2017.

-Shkresa nr.1017/1 protdatë 31.07.2017 e ASHA.

-vendimin nr.144 datë 26.07.2017të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, **KryetarjaMirela Kumbaro**.

-shkresa nr.258/1 protdatë 31.07.2017 e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

--vendim nr.197 datë26.07.2017 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve,**Kryetarja MirelaKumbaro**.

Në të dy vendimet 144datë 26.07.2017 të KKA dhe nr.197 datë 26.07.2017 të KKR,(pika “1” është e përbashkët),është vendosur:

“1.Tëmiratojë Projekt-propozimin për ndryshimet e projektit te rehabilitimit “Sheshit Publikpara hyrjes së Portit të ** it”,nëlidhje me ruajtjen dhe integrimin e strukturave më përfaqësuese të zbuluaragjatë gërmimit arkeologjik,realizuar nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK***** .***

2. ***** duhet të depozitojë pranëASHA,projektin e zbatimit me ndryshimet për ruajtjen dhe integrimin estrukturave më përfaqësuese dhe detajimet përkatëse,sipas sugjerimeve tëKKR,duke evidentuar gjurmën e gërmimeve,të shoqëruar me itinerarin dhe tabelatshpjeguese.”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Gjykata duke krahasuarpërbajtjen e këtyre vendimeve me shkresën nr.1017/1prot datë31.07.2017,konstaton se në këtë shkresë thuhet:

“

****** ***** duhet të realizojë kushtet e përcaktuara në vendimin e sipërpërmendur,tëdepozitojë pranë ASHA,projektin e zbatimit me ndryshimet për ruajtjen dheintegrimin e strukturave më përfaqësuese dhe detajimet përkatëse,sipassugjerimeveve të KKR,duke evidentuar gjurmën e gjurmëve,të shoqëruar meitinerarin dhe tabelat spjeguese.”*

Nga analiza e këtyredokumenteve të paraqitura para gjykatës, konstatohet se si KKA dhe KKR,kanëmiratuar vetëm projekt-propozimin e Bashkisë ***** ,kurse para tyre nuk ështëparaqitur projekti i zbatimit,kjo tregon se këto dy institucione nuk janë *organe shtetërore serioze*.

Ato kur kanë miratuar këtë projekt,nuk kanë qënë fare në dijeni të projektit të zbatimit,por të njëprojekt propozimi formal, i cili nuk përbën kusht që ato si institucione të pranonin këtë ndryshim, mbasi nuk e dinin, nëse projekti i zbatimit prek ose jo mbetjetarkeologjike,mbasi nga vetë vendimet e tyre rezulton se ata nuk e kishin atë.

Ky fakt vërtetohet dhenga shkresa nr.1017/1 prot datë 31.07.2017 e ASHA, e cila kërkon nga ***** , projekt zbatimin e “Velierës” mbasi ajo aktualisht nuk e ka atë.

Nga ana e Bashkisë***** , u paraqit edhe një fletë A3, që sipas saj përbën projektin e zbatimitndërtimor të “Velierës”.

Gjykata vlerëson sefotografimi i një flete me stampime figurale të “Velierës” nuk përbën njëprojekt të saj, i cili ka një përbajtje tjetër,ku në të të jepen spjegimelidhur me ndërtimin si dhe pozicionimi i ndërtimeve të saj në raport me mbetjetarkeologjike.

Gjykata e Apelit ***** me vendimin e saj nr.59 datë 27.03.2017, arsyeton:

“

*Sipas vlerësimit të ***** së Apelit,marrja emasave për pezullimin e një investimi publik,duhet tëe jetë rezultat i njëhetimi të plotë dhe serioz,që ka çuar në bindjen e ekzistencës së të dhënavepër kryerjen e veprës penale.*

*Në këtë rast gjykata bindet se jemi para veprimevenë kundërshtim me ligjin të kryera nga pala investitore ***** ,funktionarët publikë përgjegjës,pasi në mënyrë të qartë nuk janë zbatuaredetyrime ligjore të një natyre të panegociushme dhe të pamundura për t’urealizuar në mënyrë tjetër.”*

Dhe kjo gjykatë vazhdon:

“

Përsa i përket përcaktimit të masës së pasojës sëardhur,Gjykata e Apelit me kompetencën që ligji procedural penal i jepgjykatës,si kontrolluese e diligjencës së veprimeve të organit të akuzës gjatëhetimit paraprak,vlerason se është e nevojshme në mënyrë të menjëhershme:

Kryerja e një ekspertimi të zgjeruar me grupekspertësh arkeologë,që do të evidentojë çdo pasojë të ardhur në këtë fazë tëzbatimit të punimeve, dhe të përcaktojnë masën e dëmit të ardhur nëtrashëgiminë kulturore të zonës,duke verifikuar çdo pretendim të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

palëskallzuese.”

Këtë kërkesë të ***** së Apelit, ***** e Rrethit Gjyqësor ***** , nuk e ka vlerësuar sa e siduhet,mbasi që nga data 27.03.2017 që është data e vendimit të asaj gjykate ederi më datën 28.09.2017, kjo prokurori nuk ka marrë asnjë masë, asnjë vendim dhe nuk ka kryer asnjë veprim procedural penal,për të zbatuar këtë detyrë të ligjshme të caktuar nga ajo gjykatë.

Në seancën e sotme kjo Prokuroriparaqiti një vendim “Për kryerjen e ekspertimit teknik në fushën e arkeologjisë” me datë 28.09.2017,ku kapërcaktuar detyrat për grupin e ekspertëve që ajo ka caktuar.

Gjykata vlerëson se kyvendim është i mangët,mbasi në ekspertim duhet të caktohen edhe ekspertë tëfushës së ndërtimit, të cilët do të vlerësonin edhe një fakt tjetër,i cili dotë përcaktojë nëse kemi elementë të figurës së veprës penale, të “shpërdorimit të detyrës”,nga ana e punonjësve të Bashkisë ***** .

Për këtë të caktohen ekspertë të kësaj fushe dhe të fushës urbanistike,të cilëve t’u shtrohen këtopyetje:

-nëse ky ndërtim i plotëson kushtet teknike të ndërtimit, në zonën ku ai është vendosur;

-aparaqet rrezik në të ardhmen kjo mënyrë ndërtimi,për mjedisin përreth si dhe për zonën arkeologjike.

-cila është vlera reale e ndërtimit dhe a i përgjigjet vlerës së prokurimit?

Gjithashtu gjykata vlerëson se prokuroria duhet të marrë edhe propozimet e shoqërisë civile kallzuese në këtë rast, për caktimin dhe prej tyre të ekspertëve që ata do të çmojnë, për të realizuar një ekspertim sa më të saktë e të besueshëm.

Lidhur me kërkesën e paraqitur prej Bashkisë ***** , gjykata vlerëson se ajo nuk mund të pranohet në kushtet e mësipërme si dhe kur nga organi i akuzës nuk është pushuar çështja penale, e cila do të vlerësohet në raport me gjithë provat e paraqitura prej subjekteve të interesuara në këtë çështje dhe përfundimit të aktit të ekspertimit.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:Gjykata pasi pa dhenet 274 vijues të KPrP,

Vendosi:

Të mospranojë kërkesën e datës 22.09.2017 të Bashkisë së Qytetit ***** , me objekt:

*Kërkesë për heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendimin nr.103 datë 03.03.2017 të ***** së Shkallës së Parë ***** ,lënë në fuqi me vendimin nr.59 datë 27.03.2017 të ***** së Apelit ***** , si të pabazuar në prova e në ligj.*

Një kopje vendimi t’idërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor ***** .

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit ***** .

***** , më 29.09.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Ky dokument është marrë nga www.gjkata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.